50 години заедно со општините ЗЕЛС

# ГЛАСИЛО
# GAZETË

50 vite bashkë me komunat BNJVL

Јануари - Февруари 2024
Janar / Shkurt 2024



## ЗЕЛС

ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

## BNJVL

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

ПОШТАРИНА ПЛАТЕНА
ВО ПОШТА 1020 СКОПЈЕ



Почитувани,

Управниот одбор на ЗЕЛС ја одржа дваесеттата седница во просториите на Општина Кисела Вода. Присутните дискутираа за повеќе актуелни предизвици, а фокусот беше ставен на членот 93, став 1 од преодните одредби од Законот за урбанистичко планирање, со кој истекува рокот од 4 години за довршување на започнатите детални урбанистички планови. Тоа значи дека голем број општини се обврзани да започнат комплетно нови постапки за недовршените ДУП-ови, а со тоа и нови финансиски средства и нов временски период за урбанизирање на одредени подрачја од општините. Дискусија се водеше и околу прашалникот, доставен од Министерството за транспорт и врски, за поодамнешната иницијатива на ЗЕЛС за измени во Законот за градежно земјиште, во однос на одредбите за дооформување на градежните парцели. Присутните ги разгледаа и наодите од Извештајот на Државниот завод за ревизија за состојбите во Јавното претпријатие за државни патишта (ЈПДП), каде што е посочено дека не е почитуван Законот за јавни патишта во делот за префрлање на 50 % од уплатените средства на сметката на ЈП по основ на надоместок на патна такса од регистрацијата на моторните возила, како приходи на единиците на локалната самоуправа. Се дискутираше и за барањето до ЗЕЛС од ЈП Водовод и канализација – Скопје за користење на информацискиот систем за продажба на движни и недвижни ствари со кој управува ЗЕЛС. Беше заклучено сите претпријатија основани од единиците на локалната самоуправа оваа постапка да ја спроведуваат преку единицата на локалната самоуправа што ги основала. Стана збор и за потребата од итно креирање на национална стратегија за справување со бездомните кучиња, а се дискутираше и за неправедното лишување на општините од дополнителни финансиски средства од разни концесии дадени на нивна територија.

Општините што се заинтересирани да интегрираат индикатори за родова еднаквост во своите годишни програми, имаат можност да добијат директна менторска поддршка од ЗЕЛС и да се пријават на поканата што ЗЕЛС ја достави до сите општини. Претставници од ЗЕЛС учествуваа на работилница за планирање на активности во рамките на проектот „Одржливо управување со отпад на локално ниво“, што го спроведува Шведската асоцијација на локални власти (САЛАР), а ЗЕЛС е партнер- организација. Активно учество имаше претставникот од ЗЕЛС и на работилницата за креирање на националните политики и стратегии за дигитална трансформација на јавните водни услуги во РСМ, со посебен осврт на местото, улогата и обврските на давателите на водни услуги, а тоа се јавните комунални претпријатија (ЈКП). Со цел јакнење на капацитетите на општинската администрација, ЗЕЛС организираше работилница на тема „Улогата на локалната самоуправа во унапредување на правата на лицата со попреченост“ на која учествуваа претставници од општините, а кои работат во областа на социјалната заштита и образованието. За сите овие и за другите активности на ЗЕЛС за овој период, подетално ќе прочитате во овој број на Гласило на ЗЕЛС

Со почит,

Душица Перишиќ,
извршен директор на ЗЕЛС

Të nderuar,

Bordi drejtues i BNJVL-së mbajti seancën e njëzetë në hapësirat e Komunës së Kisella Vodës. Të pranishmit diskutuan për më shumë sfida aktuale, ndërsa fokusi u vu në nenin 93, paragrafi 1 i dispozitave kalimtare të Ligjit për planifikim urbanistik, me të cilin skadon afati 4 vjeçar për përfundimin e planeve të filluara të detajuara urbanistike. Kjo do të thotë se një numër i madh i komunave janë të obliguara që të fillojnë procedura krejtësisht të reja për PDU-të e papërfunduara, e me këtë edhe mjete të reja financiare dhe një periudhë të re kohore për urbanizimin e zonave të caktuara të komunave. Diskutim pati edhe rreth pyetësorit të dërguar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve për iniciativën e kohës më parë të BNJVL-së për ndryshime në Ligjin për tokën ndërtimore, në lidhje me dispozitat për kompletimin e parcelave ndërtimore. Të pranishmit shqyrtuan edhe të gjeturat e Raportit të Entit Shtetëror të Revizionit për gjendjen në Ndërmarrjen Publike për Rrugët Shtetërore (NPRRSH), ku u konstatua se nuk është respektuar Ligji për rrugët publike në pjesën për alokimin e 50% të mjeteve të paguara në llogarinë e NP-së në bazë të rimbursimit të taksës rrugore nga regjistrimi i mjeteve motorike, si të ardhura të njësive të vetëqeverisjes lokale. U diskutua edhe për kërkesën e NP-së “Ujësjellësi dhe Kanalizimi – Shkup”, dërguar BNJVL-së për shfrytëzimin e sistemit të informacioneve për shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme me të cilin menaxhon BNJVL-ja. U konstatua se të gjitha ndërmarrjet e themeluara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet ta zbatojnë këtë procedurë përmes njësisë së vetëqeverisjes lokale që i ka themeluar. U bë fjalë edhe për nevojën e krijimit urgjent të një strategjie kombëtare për trajtimin e qenve të pastrehë, si dhe u diskutua për privimin e padrejtë të komunave nga mjetet shtesë financiare nga koncesione të ndryshme të dhëna në territorin e tyre.

Komunat të cilat janë të interesuara për të integruar indikatorët e barazisë gjinore në programet e tyre vjetore kanë mundësi të marrin mbështetje direkte mentoruese nga BNJVL-ja dhe të paraqiten për ftesën që BNJVL-ja u ka dërguar të gjitha komunave. Përfaqësuesit e BNJVL-së morën pjesë në punëtorinë për planifikimin e aktiviteteve në kuadër të projektit “Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave në nivel lokal”, i cili zbatohet nga Asociacioni Suedez i Autoriteteve Lokale (SALAR), ndërsa BNJVL është organizatë partnere. Përfaqësuesi i BNJVL-së mori pjesë në mënyrë aktive edhe në punëtorinë për krijimin e politikave dhe strategjive kombëtare për transformimin digjital të shërbimeve publike të ujit në RMV, me theks të veçantë për vendin, rolin dhe obligimet e ofruesve të shërbimeve të ujit, e ato janë ndërmarrjet publike komunale (NPK). Me qëllim të përforcimit të kapaciteteve të administratës komunale, BNJVL-ja organizoi punëtori me temë “Roli i vetëqeverisjes lokale në avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara”, në të cilën morën pjesë përfaqësues nga komunat të cilët punojnë në sferën e mbrojtjes sociale dhe arsimit. Për të gjitha këto dhe aktivitetet e tjera të BNJVL-së për këtë periudhë do të lexoni më hollësisht në këtë numër të Gazetës së BNJVL-së.

Me respekt,

Dushica Perishiq,
drejtor ekzekutiv i BNJVL-së


**ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**
тел. +389 (0) 2 30 99 033, факс: +389 (0) 2 30 61 994
ул. Копенхагенска бр. 5, п.фах 32,
1000 Скопје, Република Северна Македонија
**Извршен директор на ЗЕЛС:**
Душица Перишиќ
**Заменик извршен директор на ЗЕЛС:**
Ардита Дема-Мехмети
**Подготвила:**
Весна Арсовска-Динковска
**Превод:** Славе Чорбев
**Лекторирал:** Валентина Великова
**Дизајн и подготовка и печатење:** Европа 92

**BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**
tel. +389 (0) 2 30 99 033, faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. „ Kopenhagenska” nr. 5, F.P. 32,
1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
**Drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Dushica Perishiq
**Zëvendes drejtor ekzekutiv i BNJVL-së:**
Ardita Dema - Mehmeti
**Përgatiti:**
Vesna Arsovska - Dinkovska
**Përkthim:** Sllave Çorbev
**Lektoron:** Valentina Velikova
**Dizajnim dhe përgatitje shtyp:** Evropa 92

## ЗЕЛС ОРГАНИЗИРАШЕ РАБОТИЛНИЦА НА ТЕМА „УЛОГАТА НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА ВО УНАПРЕДУВАЊЕ НА ПРАВАТА НА ЛИЦАТА СО ПОПРЕЧЕНОСТ“

„Улогата на локалната самоуправа во унапредување на правата на лицата со попреченост“ беше темата на работилницата што ја организираше ЗЕЛС во просториите на ЗЕЛС тренинг центарот, на 12 јануари 2024 година, а на која беа поканети претставници од општините кои работат во областа на социјалната заштита и на образованието. Работилницата беше реализирана со поддршка на ГИЗ и во соработка со Фондацијата за културни и образовни иницијативи „Чекор по чекор“, Министерството за труд и социјална политика и Националното координативно тело за имплементација на Конвенцијата на ООН за правата на лицата со попреченост.

**Учество на локалната самоуправа во спроведувањето на Стратегијата за правата на лицата со попреченост и на Акцискиот план за спроведување 2023 – 2026 година**

На почетокот на работилницата, претставничката од Националното координативно тело за имплементација на Конвенцијата на ООН за правата на лицата со попреченост, Лидија Крстеска Дојчиновска, ги презентираше принципите на оваа Конвенција што е ратификувана од Собранието на нашата земја во декември 2011 година. Изработена е и Стратегија за правата на лицата со попреченост 2023 – 2030 година со Акциски план за спроведување 2023 – 2026 година. Утврдени се девет приоритетни области во Стратегијата, и тоа: обезбедување на пристапност; еднаквост, пристап до правда и активно учество во јавниот и политичкиот живот; пристап до здравствена заштита; детска, социјална заштита и независно живеење; право на образование; вработување

## BNJVL-JA ORGANIZOI PUNËTORI ME TEMËN “ROLI I VETËQEVERISJES LOKALE NË AVANCIMIN E TË DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA”

“Roli i vetëqeverisjes lokale në avancimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara” ishte tema e punëtorisë të cilën e organizoi BNJVL-ja në hapësirat e Qendrës së Trajnimeve të BNJVL-së, më 12 janar 2024, në të cilën u ftuan përfaqësues të komunave të cilët punojnë në sferat e mbrojtjes sociale dhe arsimit. Punëtoria u realizua me mbështetjen e GIZ-it dhe në bashkëpunim me Fondacionin “Hap pas hapi”, Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe Trupin koordinues kombëtar për zbatimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

**Pjesëmarrja e vetëqeverisjes lokale në zbatimin e Strategjisë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Planit aksionar të zbatimit 2023-2026**

Në fillim të punëtorisë, përfaqësuesja e Trupit koordinues kombëtar për zbatimin e Konventës së OKB-së për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, Lidija Kërsteska Dojçinovska, prezantoi parimet e kësaj Konvente që është ratifikuar nga Kuvendi i vendit tonë në dhjetor të vitit 2011. Gjithashtu është përgatitur edhe një Strategji për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara 2023-2030 me një Plan aksionar zbatimi 2023-2026. Në Strategji janë përcaktuar nëntë sfera prioritare, përkatësisht: sigurimi i qasshmërisë, barazia, qasja në drejtësi dhe pjesëmarrja aktive në jetën publike dhe politike, qasja në mbrojtjen shëndetësore, mbrojtja e fëmijëve, mbrojtja sociale dhe jetesa e pavarur, e drejta për arsim, punësimi dhe e drejta



и право на работа; локални инклузивни заедници; јавна свест и култура, спорт и рекреација. Првиот приоритет се однесува на реконструкција и адаптација на урбаните површини и објекти за подобрување на пристапноста за лицата со попреченост. Тука се подразбира и обновување и зголемување на бројот на обележани паркинг-места, како и адаптација на веб-страниците на општините и другите јавни институции со примена на стандардите за веб-пристапност за лицата со оштетен вид. Исто така, во рамките на обезбедување пристапност се предвидува субвенционирање за пристапност на домовите на лицата со попреченост и субвенционирање на полагање возачки испит. Во Акцискиот план во приоритетите на пристапот до правда и активно учество во политичкиот живот, опфатени се активностите за отстранување на бариерите за остварување на правото на глас на избирачките места, како и вклучување на правата и потребите на овие лица во програмите и буџетот на институциите на локално ниво (по примерот на родово одговорно буџетирање). Потоа, во приоритетните активности се предвидува и зајакнување на капацитетите на државната и локалните комисии за заштита на правата на пациентите; изградба и адаптација на предучилишните установи согласно со стандардите за пристапност, како и нивно соодветно опремување; обезбедување услуги за живеење со поддршка за лицата со попреченост на локално ниво; развој на мрежата на даватели на услуги на локално ниво согласно со потребите на лицата со попреченост, како и воспоставување на систем за мониторинг и евалуација на спроведувањето на социјалните услуги од страна на општините. За улогата на локалните власти во спроведувањето на мерките од областа на социјалната заштита и образованието, говореше и Душан Томшиќ од Министерството за труд и социјална политика.

për punë, komunitetet lokale përfshirëse, ndërgjegjësimi dhe kultura publike, sporti dhe rekreacioni. Prioriteti i parë ka të bëjë me sigurimin e rindërtimit dhe adaptimin e sipërfaqeve dhe objekteve urbane për të përmirësuar qasshmërinë për personat me aftësi të kufizuara. Këtu nënkuptohet rivitalizimi dhe rritja e numrit të hapësirave të shënuara për parkim, si dhe adaptimi i faqeve të internetit të komunave dhe institucioneve të tjera publike duke zbatuar standardet e qasshmërisë në faqet e internetit për personat me shikim të dëmtuar. Gjithashtu, në kuadër të sigurimit të qasjes parashihet subvencionimi i qasjes në banesat e personave me aftësi të kufizuara dhe subvencionimi i testimit për patentë shoferi. Në Planin aksionar, në prioritetet e pjesës së qasjes në drejtësi dhe pjesëmarrjes aktive në jetën politike përfshihen aktivitetet për heqjen e barrierave për realizimin e së drejtës së votimit në vendet e votimit, si dhe përfshirjen e të drejtave dhe nevojave të këtyre personave në programet dhe buxhetet e institucioneve në nivel lokal (sipas shembullit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor). Pastaj, në aktivitetet prioritare parashihet edhe përforcimi i kapaciteteve të komisioneve shtetërore dhe lokale për mbrojtjen e të drejtave të pacientëve, ndërtimi dhe adaptimi i institucioneve parashkollore sipas standardeve të qasshmërisë, si dhe të pajisurit e tyre përkatës, sigurimi i shërbimeve për jetesë me mbështetje për personat me aftësi të kufizuara në nivel lokal, zhvillimi i rrjetit të ofruesve të shërbimeve në nivel lokal sipas nevojave të personave me aftësi të kufizuara si dhe vendosja e një sistemi për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të shërbimeve sociale nga ana e komunave. Për rolin e autoriteteve lokale në zbatimin e masave në sferën e mbrojtjes sociale dhe arsimit foli edhe Dushan Tomshiq nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale.









### Обезбедени сензорно-ресурсни соби во пет општини

Пред присутните беше презентиран и проектот „Инклузивни општини преку квалитетно образование“ што го спроведува Фондацијата за културни и образовни иницијативи „Чекор по чекор“, во 34 училишта во пет општини: Битола, Велес, Кочани, Ресен и Штип. Клучни согледувања за проектот даде Бранка Џајковска, а за искуствата од опремувањето на сензорните соби говореше Елена Мишиќ, и двете претставнички од Фондацијата. Беше посочено дека во соработка со училиштата и општините, за секоја општина е направена поединечна лична карта за пристапност и подготвеност за инклузија на учениците со попреченост во училиштата. Утврден е бројот на деца со попреченост; условите за пристапност до и во училишните згради, спортските сали, училишниот двор; потоа утврдена е состојбата со постоење на пристапни тоалети; држачи на пристапните рампи и тактилни патеки за лицата со оштетен вид; потоа дали има сензорно-ресурсна просторија во училиштето; а утврдена е и подготвеноста и потребите на училишниот кадар, како и други важни податоци. Во рамките на проектот се реализирани и едукативни работилници за подобрување на вештините и на родителите на учениците со попреченост; опремени се и пет сензорно-ресурсни соби во сите пет општини, а за нивната корисност и значење за лицата со попреченост говореа Ајфер Аџигора, директорка на Општинското основното училиште „Мите Богоевски“ од Општина Ресен и Никола Ристовски, специјален едукатор и рехабилитатор.

### Janë siguruar dhoma me sensorë dhe resurse në pesë komuna

Para të pranishmëve u prezantua edhe projekti “Komunat përfshirëse përmes arsimit cilësor”, të cilin e zbaton Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Hap pas hapi” në 34 shkolla në pesë komuna: Manastir, Veles, Koçan, Resnjë dhe Shtip. Branka Xhajkovska dha vërejtjet kryesore për projektin, ndërsa Elena Mishiq dhe dy përfaqësueset e Fondacionit folën për përvojat e të pajisurit të dhomave me sensorë. U theksua se në bashkëpunim me shkollat dhe komunat është bërë një dokument individual identifikimi për secilën komunë për qasshmëri dhe gatishmëri për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara në shkolla. Është përcaktuar numri i fëmijëve me aftësi të kufizuara, kushtet për qasshmëri deri te dhe në objektet shkollore, sallat sportive, oborrin e shkollës. Pastaj u konstatua gjendja me ekzistencën e tualeteve të qasshme, parmakë në rampat e hyrjes dhe shtigjet prekëse për personat me shikim të dëmtuar, pastaj nëse ka një hapësirë me resurse dhe sensorë në shkollë dhe janë përcaktuar gatishmëria dhe nevojat e stafit të shkollës si dhe të dhëna të tjera të rëndësishme. Në kuadër të projektit janë realizuar edhe punëtori edukative për përmirësimin e aftësive të prindërve të nxënësve me aftësi të kufizuara. Në kuadër të projektit janë pajisur pesë dhoma me resurse dhe sensorë në të gjitha pesë komunat, ndërsa për dobinë dhe rëndësinë e tyre folën Ajfer Axhigora, drejtoreshë e Shkollës Fillore Komunale “Mite Bogoevski” nga Komuna e Resnjës dhe Nikola Ristovski, edukator dhe rehabilitues special.

## МОЖНОСТ ЗА ОПШТИНИТЕ ДА ГИ ПРОШИРАТ КАПАЦИТЕТИТЕ НА ЈАВНИТЕ ДЕТСКИ УСТАНОВИ

Министерката за труд и социјална политика, Јованка Тренчевска, на 18 јануари 2024 година, имаше онлајн средба со градоначалниците на која го најави јавниот повик за аплицирање за грант за креирање на дополнителни места во предучилишните установи преку адаптации на постојните објекти и ги охрабри руралните општини активно да учествуваат. Целта е да се зголеми опфатот на деца во предучилишното образование, како и да се подобрат условите во нив. Средствата се обезбедени преку „Проект за подобрување на социјалните услуги“ финансиран со средства од заемот на Светската банка, што го реализира МТСП. Од вкупно милион и шестотини илјади долари, еден милион и триста се предвидени за адаптациите, а триста илјади долари ќе се користат за опремување на адаптираните објекти.

### Адаптација на простор во сопственост на општината или на простор што е во државна сопственост

Заинтересираните општини треба да аплицираат најдоцна до 1 април 2024 година и да идентификуваат соодветни објекти (училишта, месни заедници или други објекти со добра статика) што се во сопственост на општината, а што можат да се адаптираат

## MUNDËSI PËR KOMUNAT PËR T'I ZGJERUAR KAPACITETET E INSTITUCIONEVE PUBLIKE TË FËMIJËVE

Ministrja e Punës dhe Politikës Sociale, Jovanka Trençevska, më 18 janar 2024, pati një takim online me kryetarët e komunave në të cilin paralajmëroi thirrjen publike për të aplikuar për grant për krijimin e vendeve shtesë në institucionet parashkollore përmes adaptimeve të objekteve ekzistuese dhe inkurajoi komunat rurale të marrin pjesë në mënyrë aktive. Qëllimi është rritja e përfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor, si dhe përmirësimi i kushteve në to. Mjetet janë siguruar nëpërmjet “Projektit për përmirësimin e shërbimeve sociale”, të financuar me mjete nga kredia e Bankës Botërore, të cilin e zbaton MPPS-ja. Nga gjithsej një milion e gjashtëqind mijë dollarë, një milion e treqind janë paraparë për adaptimet, ndërsa treqind mijë dollarë do të përdoren për pajisjen e objekteve të adaptuara.

### Adaptim i hapësirës në pronësi të komunës ose i hapësirës që është në pronësi të shtetit

Komunat e interesuara duhet të aplikojnë më së voni deri më 1 prill 2024 dhe të identifikojnë objektet përkatëse (shkolla, bashkësi lokale apo objekte të tjera me statikë të mirë) që janë në pronësi të komunës dhe të cilat mund të adaptohen ose shndërrohen në hapësira për arsim parashkollor me qëndrim gjithëditor të

или пренаменат во простории за предучилишно образование со целодневен престој на децата. Исто така, општините може да аплицираат за пренамена или адаптација на простор што е во државна сопственост, но притоа треба да спроведат соодветни постапки за добивање на трајно користење на објектот. Во јавниот повик (https://www.ssip.mk/javen-povik-2/), прецизно се наведени сите потребни документи што општината треба да ги достави во апликацијата, меѓу кои се: Имотен лист за потврдување дека објектот е во сопственост на општината или ако е во државна сопственост да достават соодветна изјава дека ќе започнат постапки за трајно користење на објектот од страна на општината. Целата постапка, вклучително и изведувањето на адаптациите, треба да заврши до 30 јуни 2025 година. Беше посочено дека по пуштање на објектот во употреба, натамошните обврски за функционирањето на објектот ќе бидат на товар на општината и дека општината ќе треба да изврши и соодветни измени на систематизацијата на кадарот во соодветната градинка. Општината треба да поднесе и барање до МТСП, односно до Министерството за финансии, за добивање на согласност за вработување на потребните кадри. Притоа присутните беа информирани дека и покрај најавите дека од 1 јануари 2024 година општината не треба да бара согласности за вработувања од Министерството за финансии, беше посочено дека сѐ уште не се реализирани потребните законски услови и затоа нема никакви промени, односно општината е задолжена да поднесе барања за вработување на кадри.

**При аплицирањето, општините ќе добијат поддршка од Проектната единица во МТСП**

Претставниците од МТСП информираа дека општините се ослободени од изработка на проект. Тоа ќе биде реализирано од Проектната единица при МТСП, која, исто така, е обврзана да го обезбеди адаптирањето и надзорот. Беше посочено дека општините може да се обратат за дополнителни информации во Проектната единица. Доколку општините имаат дилема при изборот на објектот што сакаат да се адаптира, Проектната единица може да обезбеди архитект кој ќе дојде на терен и ќе им помогне за најсоодветен избор. Беше нагласено дека за сите потребни информации околу јавниот оглас и потребните документи ќе биде контактирана и ЗЕЛС која потоа ќе ги достави до сите општини.

fëmijëve. Gjithashtu, komunat mund të aplikojnë për konvertimin apo adaptimin e një hapësire që është në pronësi shtetërore, por duhet të zbatojnë procedurat përkatëse për marrjen e shfrytëzimit të përhershëm të objektit. Në thirrjen publike (https://www.ssip.mk/javen-povik-2/) janë të specifikuara në mënyrë precize të gjitha dokumentet e nevojshme që komuna duhet t'i dorëzojë në aplikacion, ndër të cilat janë: Certifikata pronësore që vërteton se objekti është në pronësi të komunës ose nëse është në pronësi shtetërore të dorëzohet deklaratë përkatëse se do të fillojnë procedurat për shfrytëzimin e përhershëm të objektit nga komuna. E gjithë procedura, duke përfshirë edhe zbatimin e adaptimeve, duhet të përfundojë deri më 30 qershor 2025. U theksua se pas lëshimit të objektit në përdorim, obligimet e mëtejshme për funksionimin e objektit do t'i barten komuna dhe se komuna do të duhet të bëjë edhe ndryshimet përkatëse të sistematizimit të stafit në kopshtin përkatës të fëmijëve. Komuna duhet të paraqesë edhe kërkesë në MPPS, gjegjësisht Ministrinë e Financave për marrjen e pëlqimit për punësimin e kuadrove të nevojshme. Njëkohësisht, të pranishmit u njoftuan se përkundër paralajmërimeve se nga data 1 janar 2024, komuna nuk duhet të kërkojë pëlqim për punësime nga Ministria e Financave, u theksua se ende nuk janë zbatuar kushtet e nevojshme ligjore dhe për këtë arsye nuk ka ndryshime, gjegjësisht komuna nuk ka obligim të parashtrojë kërkesa për punësim të kuadrove.

**Në rastin e aplikimit, komunat do të fitojnë mbështetje nga Njësia e projekteve në MPPS**

Përfaqësuesit e MPPS-së informuan se komunat janë të liruara nga procedura e përpilimit të projektit. Ajo gjë do të zbatohet nga Njësia e projekteve në MPPS, e cila gjithashtu është e obliguar të sigurojë adaptimin dhe mbikëqyrjen. U theksua se komunat mund t'i drejtohen Njësisë së projekteve për informata shtesë. Nëse komunat kanë dilemë kur zgjedhin objektin që duan ta adaptojnë, Njësia e projekteve mund të sigurojë një arkitekt që do të dalë në terren dhe do t'i ndihmojë të bëjnë zgjedhjen më të përshtatshme. U theksua se BNJVL-ja do të kontaktohet për të gjitha informatat e nevojshme për shpalljen publike dhe dokumentet e nevojshme, e cila pastaj do t'i dërgojë ato në të gjitha komunat.





## ОПШТИНИТЕ ПОСВЕТЕНИ ДА ОБЕЗБЕДАТ ПОДОБРО МЕСТО ЗА РАСТЕЊЕ НА ДЕЦАТА И НА МЛАДИТЕ

Со цел општините да станат подобро место за растење на децата и на младите, претставници од општинската администрација и од воспитно-образовните установи од општините: Велес, Виница, Кисела Вода, Дебар и Гостивар, учествуваа на дводневната работилница што се одржа на 25 и 26 јануари 2024 година, во Охрид. Работилницата беше организирана во рамките на проектот „Место за растење: Општини посветени на децата" што го поддржува ЗЕЛС, а го спроведуваат Центарот за семејно и детско згрижување - КМОП Скопје и Првата детска амбасада „Меѓаши". Проектот е финансиран од Европската Унија. Целта на проектот е преку поддршка на петте пилот-општини да се зајакнат напорите на локалните власти за унапредување на правата на децата и нивното учество во креирањето на политики на локално ниво за развивање на локални стратешки документи за правата на децата и младите на возраст од 3 до 18 години; поддршка и зајакнување на децата и младите за вклучување во креирање на политиките, како и унапредување на капацитетите на одговорните лица од општините, училиштата и градинките за обезбедување на соодветна поддршка за потребите на децата.

Присутните учеа како да создадат тим, како да организираат обуки, како да комуницираат и како на наједноставен начин да ги пренесат сите потребни информации до институциите и до децата. Претставниците од општинската администрација говореа и за формалните начини, односно за законските обврски на општините за формирање тела и органи преку кои даваат поддршка или превенираат одредени состојби поврзани со децата и младите. Учесниците на обуката ја посетија Општина Охрид, од каде добија сознанија за активностите што таа ги реализира во насока на поддршка на младите и грижа за спроведување на правата на децата.

### Обврска на општината да формира Локален младински совет

Со цел поттикнување на младински ангажман и активно учество на младите во процесите на донесување одлуки на локално ниво, општините, врз основа на Законот за младинско учество и младински политики, имаат обврска да го поддржат формирањето на Локален младински совет (ЛМС). Тоа е тело на локалната самоуправа кое го сочинуваат млади претставници на различните форми на организирање во општината. ЛМС има улога да го гарантира младинското учество на локално ниво. Во таа насока, општините треба првенствено да го усогласат Статутот на општината за формирање на вакво тело, а за спроведување на целата постапка за формирање на ЛМС, изработен е Прирачник.




## KOMUNAT JANË TË PËRKUSHTUARA TË SIGUROJNË NJË VEND MË TË MIRË PËR RRITJEN E FËMIJËVE DHE TË RINJVE

Me qëllim që komunat të bëhen një vend më i mirë për rritjen e fëmijëve dhe të rinjve, përfaqësues nga administrata komunale dhe institucionet edukative-arsimore nga komunat: Veles, Vinicë, Kisella Vodë, Dibër dhe Gostivar, morën pjesë në punëtorinë dyditore që u mbajt më 25 dhe 26 janar 2024, në Ohër. Punëtoria u organizua në kuadër të projektit "Vendi për t'u rritur: Komunat e përkushtuara ndaj fëmijëve" që e mbështet BNJVL-ja, ndërsa e zbaton Qendra për përkujdesje familjare dhe të fëmijëve - KMOP Shkup dhe Ambasada e parë për fëmijë "Megjashi". Projekti është financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i projektit është që përmes mbështetjes së pesë pilot – projekteve të forcohen përpjekjet e autoriteteve lokale për të avancuar të drejtat e fëmijëve dhe pjesëmarrjen e tyre në krijimin e politikave në nivel lokal për zhvillimin e dokumenteve strategjike lokale për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve në moshë prej 3 deri në 18 vjeçare; mbështetjen dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve për përfshirje në krijimin e politikave, si dhe avancimin e kapaciteteve të personave përgjegjës nga komunat, shkollat dhe kopshtet e fëmijëve për sigurimin e një mbështetjeje adekuate për nevojat e fëmijëve.

Të pranishmit mësonin se si të krijojnë një ekip, si të organizojnë trajnime, si të komunikojnë dhe si të përcjellin të gjitha informacionet e nevojshme deri tek institucionet dhe fëmijët në mënyrën më të thjeshtë. Përfaqësuesit nga administrata komunale folën edhe për mënyrat formale, përkatësisht për obligimet ligjore të komunave për themelimin e trupave dhe organeve përmes të cilave japin mbështetje apo parandalojnë situata të caktuara të lidhura me fëmijët dhe të rinjtë. Pjesëmarrësit në trajnim vizituan Komunën e Ohrit, ku u informuan lidhur me aktivitetet që ajo realizon në drejtim të mbështetjes së të rinjve dhe përkujdesjes për zbatimin e të drejtave të fëmijëve.

### Obligim i komunës të formojë Këshillin lokal rinor

Me qëllim të inkurajimit të angazhimit të të rinjve dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel lokal, komunat, në bazë të Ligjit për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat e të rinjve, kanë obligim të mbështesin formimin e Këshillit lokal rinor (KLR). Ai është trup i vetëqeverisjes lokale, i cili përbëhet nga përfaqësues të rinj të formave të ndryshme të organizimit në komunë. KLR-i ka një rol për të garantuar pjesëmarrjen e të rinjve në nivel lokal. Në atë drejtim, komunat para së gjithash duhet të harmonizojnë Statutin e komunës për formimin e një trupi të këtillë, ndërsa për zbatimin e gjithë procedurës për formimin e KLR-it është përgatitur një Doracak.



Со Законот за младинско учество и младински политики, за првпат се гарантира младинското учество и за првпат се дефинира што е млад човек, младинска политика, младинско учество, младинска работа и младински работник. Според овој Закон, за младински прашања општината од својот буџет на годишно ниво е обврзана да издвојува средства во висина од најмалку 0,1 %. Присутните посочија дека досега вакво тело формирале само 21 општина, а 69 % од општините именувале службеник за млади, исто така, обврска на општината утврдена со овој Закон.

Me Ligjin për pjesëmarrjen e të rinjve dhe politikat e të rinjve garantohet pjesëmarrja e të rinjve për herë të parë dhe definohet për herë të parë se çfarë është njeriu i ri, politika e të rinjve, pjesëmarrja e të rinjve, puna e të rinjve dhe punëtori rinor. Sipas këtij ligji, komuna është e obliguar të ndajë së paku 0.1% të mjeteve nga buxheti i saj vjetor për çështjet e të rinjve. Të pranishmit theksuan se deri më tani vetëm 21 komuna kanë formuar një trup të tillë, ndërsa 69% e komunave kanë emëruar nëpunës për të rinj, gjithashtu obligim i komunës i përcaktuar me këtë ligj.

### Совет за превенција на детско престапништво

Во согласност со одредбите од Законот за правда на децата, општините се обврзани да формираат Совет за превенција на детско престапништво, што ги следи состојбите, отпочнува иницијативи за нивното подобрување и развива програми за вклучување на локалната заедница во превенција на детското престапништво и третманот на деца сторители на дејствија што со закон се предвидени како кривични дела и прекршоци. Бројот на членови во ова тело зависи од обемот на детското претстапништво во општината, од развиеноста, големината и потребите на општината. Советот за превенција на детско престапништво поднесува годишен извештај до Советот на општината и до Државниот совет за превенција на детско престапништво, а е финансиран од буџетот на општината, врз основа на изработената годишна програма. Во составот се вклучени претставници од локалната власт, од полицијата, од центрите за социјална работа, од советите на родители од основно и од средните училишта, од Унијата на средношколци, адвокати, здруженија и претставници од судските органи.

### Këshilli për parandalimin e delikuencës së fëmijëve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për drejtësi të fëmijëve, komunat janë të obliguara të formojnë Këshillin për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, i cili monitoron situatën, inicion iniciativa për përmirësimin e tyre dhe zhvillon programe për përfshirjen e bashkësisë lokale për parandalimin e delikuencës së fëmijëve dhe trajtimin e fëmijëve kryerës të veprave që parashikohen me ligj si krime dhe kundërvajtje. Numri i anëtarëve në këtë tru varet nga vëllimi i delikuencës së fëmijëve në komunë, nga zhvillimi, madhësia dhe nevojat e komunës. Këshilli për parandalimin e delikuencës së fëmijëve i dërgojë një raport vjetor Këshillit të komunës dhe Këshillit shtetëror për parandalimin e delikuencës së fëmijëve, i cili është financuar nga buxheti i komunës, në bazë të programit të përgatitur vjetor. Në përbërje janë përfshirë përfaqësues nga pushteti lokal, policia, qendrat për punë sociale, këshillat e prindërve nga shkollat fillore dhe ato të mesme, Unioni i nxënësve të shkollave të mesme, avokatët, shoqatat dhe përfaqësuesit e organeve gjyqësore.

## „РЕГИОНАЛНА СОРАБОТКА СО ПОДОБРА СОЦИЈАЛНА ИНКЛУЗИЈА НА ЛОКАЛНО НИВО“

На регионалната работилница во рамките на проектот „Регионална соработка со подобра социјална инклузија на локално ниво“, што се одржа во периодот од 6 до 8 февруари 2024 година во Тирана, Албанија, учествуваа по еден претставник од општинската администрација и од граѓанските организации „Бравура“ и „Наша порака“ од општините Делчево и Куманово, како и еден претставник од ЗЕЛС. Станува збор за проект во кој е вклучена ЗЕЛС и двете пилот-општини од нашата земја заедно со општини и здруженија на локалните власти од Србија, Албанија, Косово и Босна и Херцеговина. Целта е активностите опфатени со овој проект да се надградат со интегрирање на родовите и миграциските аспекти за подобра социјална и економска инклузија на ранливите групи во општините. Проектот го финансира Сојузното германското министерство за економска соработка и развој, а го спроведуваат Мрежата на здруженија на локалните власти од земјите од Југоисточна Европа (НАЛАС) и ГИЗ.

На тридневната обука за интегрирање на родовите и миграциските аспекти во социјалните политики и услуги, фокусот беше ставен на спроведување на социјалното мапирање и јакнење на услугите што се испорачуваат преку Дневниот центар. Општините Делчево и Куманово досега покажаа голем напредок во однос на обезбедувањето социјални услуги за граѓаните, а воспоставувањето на

## “BASHKËPUNIMI RAJONAL ME NJË PËRFSHIRJE MË TË MIRË SOCIALE NË NIVEL LOKAL”

Në punëtorinë rajonale në kuadër të projektit “Bashkëpunimi rajonal me një përfshirje më të mirë sociale në nivel lokal”, që u mbajt në periudhën nga 6 deri më 8 shkurt 2024 në Tiranë, Shqipëri, morën pjesë nga një përfaqësues nga administrata komunale dhe nga organizatat e shoqërisë civile “Bravura” dhe “Nasha poraka” nga komunat Dellçevë dhe Kumanovë, si dhe një përfaqësues nga BNJVL-ja. Bëhet fjalë për një projekt në të cilin përfshihen BNJVL-ja dhe dy pilot komunat nga vendi ynë së bashku me komuna dhe shoqata të autoriteteve lokale nga Serbia, Shqipëria, Kosova dhe Bosnja e Hercegovina. Qëllimi është që aktivitetet të cilat përfshihen me këtë projekt të përmirësohen duke integruar aspektet gjinore dhe ato të migracionit për një përfshirje më të mirë sociale dhe ekonomike të grupeve të ndjeshme në komuna. Projekti financohet nga Ministria Federale Gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim, ndërsa zbatohet nga Rrjeti i Asociacioneve të Vetëqeverisjeve Lokale nga vendet e Evropës Juglindore (NALAS) dhe GIZ.

Në trajnimin treditor për integrimin e aspekteve gjinore dhe të migracionit në politikat dhe shërbimet sociale, fokusi ishte në zbatimin e hartëzimit social dhe forcimin e shërbimeve që zbatohen përmes Qendrës Ditore. Komunat Dellçevë dhe Kumanovë deri më tani kanë treguar një progres të madh lidhur me sigurimin e shërbimeve sociale për qytetarët, ndërsa themelimi i Qendrës ditore




Дневен центар го реализираат со здружението „Бравура“ од Делчево и „Наша порака“ од Куманово.

На обуката ѝ претходеше истражување во петте земји за утврдување на актуелната состојба на спроведување на родовата интеграција во локалните политики, грижата за мигрантите и креирањето мерки за нивна интеграција, што го спроведе експертката Марија Као, ангажирана од ГИЗ. Беа реализирани повеќе онлајн интервјуа со одговорните од општинската администрација и со граѓанските здруженија од пилот-општините, како и со претставниците од здруженијата на локалните власти. Експертката ги презентираше резултатите од истражувањето на оваа работилница, при што изнесе и одредени препораки за развивање на концепти за подобро интегрирање на родовата еднаквост и миграцијата во социјалните услуги. Искуствата на општините за родовото интегрирање во локалните политики и буџет се на различно ниво, па од голема полза беа презентираните позитивни и негативни примери. За разлика од општините во Косово и Босна и Херцеговина, кои изнесоа практични примери и мерки за интегрирање на мигрантите, општините од нашата земја, можеби поради законската поставеност, ги презентираа основните информативни услуги што им ги даваат на своите граѓани кои се вратиле во земјата. Сите учесници работеа на конкретни примери и концепти што треба понатаму да ги развијат во своите општини заедно со давателите на услуги (здруженијата), за што од проектот ќе добијат финансиска поддршка од 5.200 евра по општина. Здруженијата на локалните власти од земјите учеснички имаат координативна улога и ќе ги поддржуваат сите активности што треба да се реализираат во период од 13 месеци.

është duke u realizuar me shoqatën “Bravura” nga Dellçeva dhe “Nasha poraka” nga Kumanova.

Trajnimit i parapriu një hulumtim në pesë vendet për të konstatuar gjendjen aktuale të zbatimit të integrimit gjinor në politikat lokale, kujdesin ndaj emigrantëve dhe krijimin e masave për integrimin e tyre, të cilin e zbatoi ekspertja Marija Kao, e angazhuar nga GIZ-i. U realizuan më shumë intervista online me personat përgjegjës nga administrata komunale dhe shoqatat e shoqërisë civile nga pilot komunat, si dhe me përfaqësues nga asociacionet e autoriteteve lokale. Ekspertja prezantoi rezultatet e hulumtimit në këtë punëtori, duke nxjerrë rekomandime të caktuara për zhvillimin e koncepteve për integrim më të mirë të barazisë gjinore dhe migracionit në shërbimet sociale. Përvojat e komunave për integrimin gjinor në politikat dhe buxhetet lokale janë në nivele të ndryshme, kështu që praktikat e prezantuara pozitive dhe negative ishin shumë të dobishme. Për dallim nga komunat në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë që prezantuan shembuj dhe masa praktike për integrimin e emigrantëve, komunat e vendit tonë, ndoshta për shkak të strukturimit ligjor, kanë prezantuar shërbimet informative bazë që u ofrojnë qytetarëve të tyre që janë kthyer në vend. Të gjithë pjesëmarrësit punonin në shembuj dhe koncepte konkrete që duhet t'i zhvillojnë më tej në komunat e tyre së bashku me ofruesit e shërbimeve (shoqatat), për të cilat do të marrin mbështetje financiare nga projekti në shumë prej 5200 Eurosh për komunë. Shoqatat e autoriteteve lokale nga vendet pjesëmarrëse kanë rol koordinues dhe do të mbështesin të gjitha aktivitetet që do të realizohen në një periudhë 13 mujore.






# РОДОВАТА ЕДНАКВОСТ ВО ФОКУСОТ НА РАЗВИВАЊЕТО ПОЛИТИКИ И УСЛУГИ ЗА УПРАВУВАЊЕ СО ОТПАД

Во Општината беше организирана презентација како ќе функционира целиот процес и примената на дел од опремата наменета за следење на виталните параметри кај граѓаните од далечина, на која беа повикани матичните лекари од општината, претставниците од Општинската организација на Црвениот крст – Делчево и од Хуманитарното здружение за помош и поддршка на лицата со посебни потреби „Бравура кооператива", како испорачувачи на социјални услуги. Виталните параметри ќе бидат прикажани графички и нумерички во реално време на централната станица монтирана кај матичниот лекар. Давателите на социјалните услуги ќе ги пренесуваат уредите во домот на пациентите на кои здравствените лица претходно им ја утврдиле потребната терапија.

Проектот ќе се реализира во текот на 2024 година и има цел да обезбеди пренесување на ваквите решенија и во други општини, каде што со примена на теле- медицината ќе се обезбеди покривање на одредени здравствени услуги во руралните подрачја.

## ME ZBATIMIN E ZGJIDHJEVE INOVATIVE, KOMUNA E DELLÇEVËS DO TË SIGUROJË MBULIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PËR PERSONAT E MOSHUAR DHE TË PAFUQISHËM NË ZONAT RURALE

Komuna e Dellçevës do të sigurojë përmirësimin e dërgimit të shërbimeve sociale- shëndetësore për qytetarët e saj duke aplikuar zgjidhjet "smart" dhe inovative. Bëhet fjalë një pilot projekt, i lidhur me sigurimin e pajisjeve të cilat do t'i përdorin mjekët amë nga komuna, e të cilat janë të dedikuara për monitorimin e parametrave vitalë shëndetësorë të qytetarëve, me fokus ndaj personave të moshuar dhe të pafuqishëm që jetojnë në zonat e larguara dhe rurale. Qëllimi është të ndihmohen njerëzit dhe të ndiqet gjendja e tyre shëndetësore, duke mos qenë të ekspozuar ndaj udhëtimeve të vazhdueshme dhe pritjes në autoambulanca.

Bartës i projektit është Komuna e Dellçevës, ndërsa realizimi i tij mbështetet nga Rrjeti i Asociacioneve të Vetëqeverisjeve Lokale në Vendet e Evropës Juglindore (NALAS), së bashku me Qendrën Hulumtuese për Administratën Publike nga Austria (KDZ) dhe me mbështetje financiare nga Agjencia Austriake për Zhvillim. Përmes projektit, komuna duhet të inkurajohet që të zbatojë edhe zgjidhje të tjera digjitale për shërbimet ndaj qytetarëve, si dhe të forcohen edhe kapacitetet administrative për zbatimin e shërbimeve "smart".

Në komunë u organizua një prezantim se si do të funksionojë i gjithë procesi dhe aplikimi i një pjese të pajisjeve të dedikuara për monitorimin e parametrave vitalë të qytetarëve nga distanca, në të cilin u ftuan mjekët amë nga komuna, përfaqësuesit e organizatës komunale të Kryqit të Kuq - Dellçevë dhe të Shoqatës Humanitare për ndihmë dhe përkrahje të personave me nevoja të veçanta "Bravura kooperativa", si dërgues të shërbimeve sociale. Parametrat vitalë do të tregohen grafikisht dhe numerikisht në kohë reale në stacionin qendror të instaluar te mjeku amë. Ofruesit e shërbimeve sociale do t'i dërgojnë pajisjet në shtëpitë e pacientëve të cilëve personat shëndetësorë paraprakisht ua kanë përcaktuar terapinë e duhur.

Projekti do të zbatohet gjatë vitit 2024 dhe ka për qëllim të sigurojë transferimin e zgjidhjeve të këtilla edhe në komuna të tjera, ku me zbatimin e telemjekësisë do të sigurohet mbulimi i shërbimeve të caktuara shëndetësore në zonat rurale.



## ОПШТИНА КИСЕЛА ВОДА – ДОМАЌИН НА ДВАЕСЕТТАТА СЕДНИЦА НА УПРАВНИОТ ОДБОР НА ЗЕЛС

Дваесеттата седница на Управниот одбор на ЗЕЛС се одржа на 15 февруари 2024 година, во салата на Советот на Општина Кисела Вода. Присутните му се заблагодарија на градоначалникот на Општината, воедно и претседател на ЗЕЛС, Орце Ѓорѓиевски, за поканата, со која се поддржува иницијативата дел од седниците на ова тело да се одржуваат и во други општини, а не само во просториите на ЗЕЛС. На оваа седница членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС дискутираа на повеќе актуелни теми од спроведувањето на надлежностите на локалната самоуправа. Посебно внимание беше посветено на постапките што треба да се преземат за да се пролонгира утврдениот рок во преодните одредби од Законот за урбанистичко планирање. Се дискутираше и за прашалниците од Министерството за транспорт и врски доставени до одредени општини за изјаснување во однос на иницијативата на ЗЕЛС за отпочнување на законски измени за процентуалната застапеност при дооформување на градежните парцели, утврдено со Законот за градежно земјиште. Присутните дискутираа и за нагласените предизвици во справувањето на општините со бездомните кучиња, како и за други тековни состојби.

На почетокот на седницата, членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС се договорија навремено да го информираат Заедничкиот консултативен комитет меѓу нашата земја и Комитетот на региони на Европската Унија дека делегатите на ЗЕЛС во ова тело не се можност да присуствуваат на седницата закажана за април. Беше предложено таа да се одложи за септември, кога нашата делегација ќе може да присуствува во полн состав и да даде активен придонес.

### Иницијатива за пролонгирање на рокот утврден во преодната одредба од Законот за урбанистичко планирање

За да се избегне огромната финансиска штета што ќе ја претрпат голем број општини што не успеале во рокот утврден во преодните одредби од Законот за урбанистичко планирање (член 93, став 1) комплетно да ги завршат постапките за донесување на започнатите урбанистички планови, беше предложено да се преземат соодветни чекори пред надлежните органи за продолжување на овој рок. Присутните беа информирани дека ЗЕЛС има поднесено барање до Собранието на РСМ да преземе активности заради итно изменување на Законот за урбанистичко планирање. Поконкретно, со иницијативата се бара утврдениот рок од четири години, да се продолжи на осум години. Причината е што донесувањето на урбанистичките планови во многу

## KOMUNA E KISELLA VODËS - NIKOQIR I SEANCËS SË NJËZETË TË BORDIT DREJTUES TË BNJVL-SË

Seanca e njëzetë e Bordit drejtues të BNJVL-së u mbajt më 15 shkurt 2024 në sallën e Këshillit të Komunës së Kisella Vodës. Të pranishmit e falënderuan kryetarin e komunës, njëherësh kryetar të BNJVL-së, Orce Gjorgjievski për ftesën me të cilën mbështetet iniciativa që një pjesë e seancave të këtij organi të mbahen edhe në komuna të tjera, e jo vetëm në hapësirat e BNJVL-së. Në këtë seancë, anëtarët e Bordit drejtues të BNJVL-së diskutuan për më shumë tema aktuale nga zbatimi i kompetencave të vetëqeverisjes lokale. Vëmendje e veçantë iu kushtua procedurave që do të ndërmerren për të prolonguar afatin e përcaktuar në dispozitat kalimtare të Ligjit për planifikim urbanistik. U diskutua edhe për pyetësorët e dorëzuar nga Ministria e Transportit dhe Lidhjeve deri te komuna të caktuara për të prononcuar lidhur me iniciativën e BNJVL-së për inicimin e ndryshimeve ligjore për përqindjen e përfaqësimit në kompletimin e parcelave ndërtimore, të përcaktuara me Ligjin për tokën ndërtimore. Të pranishmit diskutuan edhe për sfidat e theksuara në ballafaqimi e komunave e qenve endacakë, si dhe për situata të tjera aktuale.

Në fillim të seancës, anëtarët e Bordit drejtues të BNJVL-së u dakorduan që ta informojnë me kohë Komitetin e Përbashkët Konsultativ ndërmjet vendit tonë dhe Komitetit të Rajoneve të Bashkimit Evropian se delegatët e BNJVL-së në këtë organ nuk kanë mundësi të marrin pjesë në seancën e caktuar për muajin prill. U propozua që ajo të shtyhet për në shtator, kur delegacioni ynë do të mund të marrë pjesë në përbërje të plotë dhe të japë një kontribut aktiv.

### Iniciativa për prolongim të afatit të përcaktuar në dispozitën kalimtare të Ligjit për planifikim urbanistik

Për të shmangur dëmin e madh financiar që do të pësojnë një numër i madh i komunave, të cilat nuk arritën t'i përfundojnë tërësisht procedurat për miratimin e planeve urbanistike të filluara brenda afatit të përcaktuar në dispozitat kalimtare të Ligjit për planifikim urbanistik (neni 93, paragrafi 1), u propozua që të ndërmerren hapa përkatës para organeve kompetente për shtyrjen e këtij afati. Të pranishmit u informuan se BNJVL-ja ka parashtruar kërkesë në Kuvendin e RMV-së për ndërmarrjen e aktiviteteve për ndryshimin urgjent të Ligjit për planifikim urbanistik. Më konkretisht, me iniciativën kërkohet që afati i përcaktuar prej katër vitesh të zgjatet në tetë vjet. Arsyeja është se miratimi i planeve urbanistike në shumë komuna është në fazën

општини е во завршна фаза, па доколку навремено не успеат да го заокружат целиот процес, тие се обврзани да започнат комплетно нова постапка за донесување на истите планови. Тоа значи повторно обезбедување соодветна документација, свикување на јавни расправи, преписки со надлежните установи инволвирани во целиот процес, што значи повторно трошење на финансиски средства, но исто така и забавување на економскиот и секаков друг развој за подрачјата за кои се повторува урбанизирањето. Беше изнесено дека од страна на одредена пратеничка група во Собранието се поднесени енормен број амандмани, што доведува до одредено блокирање на можноста за навремено интервенирање од Собранието на РСМ. Затоа, беше предложено дополнително да се известат сите пратенички групи во Собранието, а потоа и Министерството за транспорт и врски, па дури и Уставниот суд за да го суспендира натамошно спроведување на оваа одредба, сè до формирањето на новата Влада и пристапување кон потребните законски измени. Управниот одбор донесе заклучок за ова прашање да се формира и работно тело во кое ќе се ангажираат експерти, претставници од општинската администрација и членови од Управниот одбор за изнаоѓање на прифатливо решение за натамошно постапување на општините.

### Дискусија околу иницијативата за измени во Законот за градежно земјиште, во однос на одредбите за дооформување на градежните парцели

Присутните беа информирани дека Министерството за транспорт и врски доставило прашалник до некои општини за нивно произнесување за целисходноста на поднесената иницијатива од страна на ЗЕЛС, за изменување и дополнување на Законот за градежно земјиште, во делот со кој се уредува постапката на отуѓување на градежното земјиште со непосредна спогодба заради дооформување на градежната парцела, што е донесена на деветтата седница на Управниот одбор на ЗЕЛС, одржана на 28 август 2022 година. Во иницијативата на ЗЕЛС се предлага, барателот за дооформување на парцелата да има во своја сопственост најмалку 70 % од градежната парцела, наместо актуелно утврдените 30 %. Присутните членови на УО посочија дека во однос на ова прашање треба добро да се размисли за последиците што може да ги предизвика одредена промена, да се разгледаат сите можни аспекти, вклучително и избегнувањето на негативностите што се јавуваат во урбаните средини, но и на можноста да се попречи економскиот развој. Беа наведени одредени размислувања во насока секој Совет на општината да го утврдува овој процент во согласност со урбанистичките приоритети и заложби на општината, но беше нагласена и потребата за утврдување со законска одредба каде што ќе се разграничи процентот според видот на градбата предвиден со Урбанистичкиот план. Управниот одбор заклучи дека треба да се формира работна група која ќе донесе одредени насоки, кои потоа ќе ги разгледа Управниот одбор, а заклучоците ќе им бидат доставени на сите општини. Беше предложено, исто така, да се прошират активностите на оваа работна група и со разгледување на можностите за усогласување на старите и новите правилници за градба. Нивната примена предизвикува голем револт кај населението и инвеститорите, бидејќи општините се соочуваат со ситуации кога на иста улица од едната страна се применува стариот правилник, со кој се ограничуваат градбите со утврден број на станбени единици, а на другата страна од улицата важи новиот правилник, кој нема такви ограничувања.

### Ревизорскиот извештај за состојбите во ЈПДП покажа неправилности на штета на општините

Членовите на Управниот одбор на ЗЕЛС беа информирани и за Извештајот на Државниот завод за ревизија за состојбите во

përfundimtare, kështu që nëse nuk arrijnë të përfundojnë me kohë të gjithë procesin, ato janë të obliguara që të fillojnë një procedurë tërësisht të re për miratimin e planeve të njëjta. Kjo do të thotë përsëri sigurim i dokumentacionit adekuat, thirrje e debateve publike, korrespodencë me institucionet kompetente të përfshira në të gjithë procesin, që do të thotë sërish shpenzim e mjeteve financiare, por edhe ngadalësim i zhvillimit ekonomik dhe të çdo zhvillimi tjetër për zonat ku urbanizimi përsëritet. U theksua se një numër i madh i amendamenteve janë dorëzuar në Kuvend nga një grup i caktuar parlamentar, gjë që çon në një bllokim të caktuar të mundësisë së ndërhyrjes me kohë të Kuvendit të RMV-së. Prandaj, u propozua që të njoftohen në mënyrë shtesë të gjitha grupet parlamentare në Kuvend, pastaj Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, madje edhe Gjykata Kushtetuese që të pezullojë zbatimin e mëtejshëm të kësaj dispozite deri në formimin e Qeverisë së re dhe realizimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore. Bordi drejtues mori konkluzion për këtë çështje që të formohet një trup punues në të cilin do të angazhohen ekspertë, përfaqësues të administratës komunale dhe anëtarë të Bordit drejtues për të gjetur një zgjidhje të pranueshme për veprimin e mëtutjeshëm të komunave.

### Diskutim për iniciativën për ndryshimet në Ligjin për tokën ndërtimore, në pjesën e dispozitave për kompletimin e parcelave ndërtimore

Të pranishmit u njoftuan se Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ka dërguar pyetësor deri te disa komuna për të prononcuar për përshtatshmërinë e iniciativës së dërguar nga ana e BNJVL-së për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tokë ndërtimore, në pjesën me të cilën rregullohet procedura e tjetërsimit të tokës ndërtimore me marrëveshje të drejtpërdrejtë për shkak të kompletimit të parcelës ndërtimore, e cila u miratua në seancën e nëntë të Bordit drejtues të BNJVL-së, të mbajtur më 28 gusht 2022. Në iniciativën e BNJVL-së propozohet që kërkuesi për kompletimin e parcelës të posedojë së paku 70% të parcelës ndërtimore, në vend se 30% sa është përcaktuar aktualisht. Anëtarët e pranishëm të Bordit drejtues theksuan se për këtë çështje duhet të mendohet mirë për pasojat që mund t'i shkaktojë ndonjë ndryshim i caktuar, të shqyrtohen të gjitha aspektet e mundshme, duke përfshirë shmangien e negativiteteve që paraqiten në zonat urbane, por edhe mundësinë e pengimit të zhvillimit ekonomik. U theksuan disa mendime në drejtim që çdo Këshill komunal të përcaktojë këtë përqindje në përputhje me prioritetet urbanistike dhe angazhimet e komunës, por u theksua edhe nevoja që me një dispozitë ligjore të përcaktohet se ku do të kufizohet përqindja sipas llojit të ndërtimit të paraparë me planin urbanistik. Bordi drejtues konkludoi se duhet të themelohet një grup punues i cili do të miratojë udhëzime të caktuara, të cilat pastaj do të shqyrtohen nga Bordi drejtues, ndërsa konkluzionet do t'u dërgohen të gjitha komunave. Gjithashtu u propozua të zgjerohen aktivitetet e këtij grupi punues duke shqyrtuar mundësitë e harmonizimit të rregulloreve të vjetra dhe atyre të reja të ndërtimit. Zbatimi i tyre shkakton një revoltë të madhe te popullata dhe investitorët, sepse komunat ballafaqohen me situata kur në të njëjtën rrugë nga njëra anë zbatohet rregullorja e vjetër me të cilën kufizohen ndërtimet me një numër të përcaktuar njësish banesore, ndërsa në anën tjetër të rrugës zbatohet rregullorja e re, e cila nuk ka kufizime të tilla.

### Raporti i auditimit për gjendjet në NPRRSH tregoi parregullsi në dëm të komunave

Anëtarët e Bordit drejtues të BNJVL-së u informuan edhe për Raportin e Entit Shtetëror të Revizionit për gjendjet në Ndërmarrjen

Јавното претпријатие за државни патишта (ЈПДП). Со извршениот увид во деловните книги на ова претпријатие, констатирано е дека не постапувало согласно со законските одредби при распределбата на остварените приходи од патната такса, за општините. Имено, посочено е дека за периодот од 2016 до 2022 година, секоја година се распределувале по 300.000 илјади денари фиксно по општина, што е помалку од законски определениот износ. Поточно, со членот 60, став 4 од Законот за јавни патишта, уредено е дека 50 % од уплатените средства на сметка на ЈП по основ на надоместок на патна такса од регистрација на моторни возила се приходи на ЈП за државни патишта, а 50 % треба да се распределат на општините, односно на Град Скопје, кои се наменети за изградба, реконструкција, одржување и заштита на општинските патишта и улици. Присутните заклучија дека ЗЕЛС треба да достави писмено барање до ЈПДП во кое ќе бара во определен рок да се изврши порамнување на недоспеаните средства до општините. Исто така, да ја информира Владата на РСМ, Министерството за транспорт и врски и другите надлежни институции и доколку не се постапи соодветно на барањето, општините ќе поднесат тужби до ова јавно претпријатие. Дополнително, Управниот одбор би утврдувал дали сите единици на локалната самоуправа заедно, преку ЗЕЛС, ќе доставаат тужба или секоја општина ќе го стори тоа поединечно.

**Информацискиот систем за продажба на движни и недвижни ствари со кој управува ЗЕЛС може да го користат исклучиво општините**

Во однос на точката разно, Управниот одбор на ЗЕЛС дискутираше и за барањето на ЈП Водовод и канализација – Скопје во кое од ЗЕЛС се бара да создаде услови за спроведување на постапка за продажба на нивни основни средства – моторни возила и отпаден материјал, со електронско јавно наддавање преку електронскиот систем на ЗЕЛС. Всушност, во согласност со одредбите од Законот за користење и располагање со ствари во државна сопственост и со ствари во општинска сопственост, продажбата се врши исклучиво по електронски пат, а ЗЕЛС управува со информацискиот систем преку кој општините ги спроведуваат овие постапки. Беше нагласено дека ЗЕЛС, уште во март 2019 година, го известила Претпријатието дека таа нема капацитет ниту обврска оваа софтверска апликација да им ја овозможи за употреба и на јавните установи и другите субјекти основани од единиците на локалната самоуправа. Доколку се дозволи такво нешто, би се оптоварил системот и може да се доведе во прашање неговата функционалност, па затоа сите претпријатија основани од единиците на локалната самоуправа оваа постапка треба да ја спроведуваат преку единицата на локалната самоуправа што ги основала.

**Потребно е итно донесување на национална стратегија за справување со бездомните кучиња**

Присутните иницираа дискусија и за состојбите во општините со кучињата бездомници, при што се дискутираше за предизвиците со кои се соочуваат општините во Град Скопје

Publike për Rrugët Shtetërore (NPRRSH). Me inspektimin e bërë në librat afaristë të kësaj ndërmarrjeje është konstatuar se ajo nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore me rastin e shpërndarjes së të hyrave të realizuara nga taksa rrugore për komunat. Përkatësisht, theksohet se për periudhën nga viti 2016 deri në vitin 2022, çdo vit janë shpërndarë nga 300.000 mijë denarë si shumë fikse për komunë, që është më pak se shuma e përcaktuar me ligj. Konkretisht, me nenin 60, paragrafi 4 i Ligjit për Rrugët Publike përcaktohet se 50% e mjeteve të paguara në llogarinë e NP-së në bazë të kompensimit të taksës rrugore nga regjistrimi i mjeteve motorike janë të hyra të Ndërmarrjes Publike për Rrugët Shtetërore, ndërsa 50 % duhet t'u shpërndahen komunave, gjegjësisht Qytetit të Shkupit, të cilat janë të dedikuara për ndërtimin, rindërtimin, mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e udhëve dhe rrugëve komunale. Të pranishmit konkluduan se BNJVL-ja duhet t'i dërgojë kërkesë me shkrim NPRRSH-së në të cilën do të kërkojë që në afat të caktuar të kryhet një shlyerje e mjeteve të pamaturuara të komunave. Gjithashtu ta njoftojë Qeverinë e RMV-së, Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve dhe institucionet e tjera kompetente dhe nëse nuk veprohet sipas kërkesës, komunat do të ngrenë padi kundër kësaj ndërmarrje publike. Gjithashtu, Bordi drejtues do të përcaktonte nëse të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, përmes BNJVL-së, do të ngrenë padi së bashku, apo secila komunë do ta bëjë këtë individualisht.

**Sistemi i informacioneve për shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme me të cilin menaxhon BNJVL-ja mund ta përdorin ekskluzivisht komunat**

Lidhur me pikën "Të ndryshme", Bordi drejtues i BNJVL-së diskutoi edhe për kërkesën e NP "Ujësjellësi dhe Kanalizimi – Shkup" me të cilën kërkohet nga BNJVL-ja të krijojë kushte për zbatimin e procedurës për shitjen e aseteve të tyre themelore - automjetet motorike dhe mbeturinat me ankand publik elektronik përmes sistemit elektronik të BNJVL-së. Në fakt, në pajtim me dispozitat e Ligjit për shfrytëzimin dhe menaxhimi e sendeve në pronësi shtetërore dhe sendeve në pronësi komunale, shitja kryhet ekskluzivisht në mënyrë elektronike, ndërsa BNJVL-ja menaxhon sistemin e informacioneve përmes të cilit komunat i zbatojnë këto procedura. U theksua se BNJVL-ja që në mars të vitit 2019 e kishte njoftuar ndërmarrjen se ajo nuk ka kapacitet, e as obligim që të mundësojë përdorimin e këtij aplikacioni softuerik nga ana e institucioneve publike dhe subjekteve të tjera të themeluara nga ana e njësive të vetëqeverisjes lokale. Nëse lejohet një gjë e tillë, sistemi do të mbingarkohej dhe do të vihej në pikëpyetje funksionaliteti i tij, prandaj të gjitha ndërmarrjet e themeluara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale duhet ta zbatojnë këtë procedurë përmes njësisë së vetëqeverisjes lokale që i ka themeluar.

**Nevojitet miratim urgjent i strategjisë kombëtare për ballafaqim me qentë e pastrehë**

Të pranishmit iniciuan një diskutim edhe për gjendjen në komunat me qentë e pastrehë, kështu që u diskutua për sfidat me të cilat ballafaqohen komunat në Qytetin e Shkupit lidhur edhe me





поврзани и со финансирањето на Јавното претпријатие за третман на улични кучиња - Лајка. Присутните нагласија дека општините се соочуваат со големи финансиски трошоци по овој основ, а ефектите се незначителни. Беше нагласено дека решавањето на ова прашање треба да се издигне на национално ниво и дека е потребно донесување на соодветна стратегија за справување со уличните кучиња. Во утврдувањето на решенијата за итно апсолвирање на овој предизвик во период од три до пет години да се вклучат соодветни експерти и претставници од локалната власт, како и граѓанските организации, бидејќи сега општините залудно трошат големи финансиски средства и ресурси без никакви резултати на теренот.

**Општините неправедно лишени од дополнителни финансиски средства поради нивно изоставување во распределбата на концесиите од фотоволтаичните централи**

Беше отпочнато и прашањето за лошата финансиска состојба во општините, особено на помалите, кои сè почесто се соочуваат со катастрофални последици од одредени одлуки донесени од централната власт, со кои им се скратуваат голем број можности за дополнителни финансиски приливи. Беше посочено дека во источниот дел од земјата, во полн интензитет е изградбата на фотоволтаичните централи од кои општините не добиваат ниту денар. Управниот одбор смета дека општините имаат право на надомест од произведена електрична енергија од алтернативни извори на енергија, во висина од најмалку 2% од паричната противвредност од произведената електрична енергија. Оваа методологија треба да се применува и при искористувањето на водите и сечата на шумите, заради што на следната седница Управниот одбор ќе расправа по изготвена предлог – иницијатива. За таа цел беше предложено да се формира комисија од членови на УО, која треба да подготви анализа и предлог- иницијативата.

Управниот одбор го утврди и составот на комисијата која треба да утврди на кои општини ќе им бидат подарени двете возила што се во сопственост на ЗЕЛС. Притоа, беа утврдени и неколку критериуми според кои треба да одлучуваат членовите во комисијата, меѓу кои: да се исклучат поголемите општини и сите општини од Скопскиот Регион; да се задржат на руралните општини што имаат максимум 10 000 жители; истите тие да не располагаат со голем возен парк и да имаат платено членарина кон ЗЕЛС. Предлозите ќе бидат разгледани на следната седница на УО.

На седницата беше усвоен Меморандумот за соработка на Здружението на граѓани за личен развој, едукација и психолошка помош и поддршка „Гласот од тишината“ - Скопје, со ЗЕЛС. Целта е да се подигне општествената свест кон децата со потешкотии во развој, создавање на вистинска инклузивност, едукација на наставниците и стручните лица од оваа област и опфаќање на врсничкото насилство („булингот“), негово препознавање и постапувањето во такви ситуации. Меморандумот ќе биде доставен до сите општини.

financimin e Ndërmarrjes Publike për trajtimin e qenve endacakë “Lajka”. Të pranishmit theksuan se në këtë bazë komunat ballafaqohen me shpenzime të mëdha financiare, ndërsa efektet janë të vogla. U theksua se zgjidhja e kësaj çështjeje duhet të ngrihet në nivel kombëtar dhe se është e nevojshme të miratohet një strategji përkatëse për trajtimin e qenve endacakë. Në përcaktimin e zgjidhjeve për zgjidhjen e menjëhershme të kësaj sfide në një periudhë prej tre deri në pesë vite duhet të përfshihen ekspertë dhe përfaqësues adekuatë nga pushteti lokal, si dhe organizatat e shoqërisë civile, sepse tani komunat po shpenzojnë mjete të mëdha financiare pa kurrfarë rezultatesh në terren.

**Komunat janë të privuar padrejtësisht nga mjete financiare shtesë për shkak të mospërfshirjes së tyre në shpërndarjen e koncesioneve nga centralet fotovoltaike**

U iniciua edhe çështja për gjendjen e keqe financiare në komunat, veçanërisht ato më të voglat, të cilat gjithnjë e më shumë po ballafaqohen me pasoja katastrofale për shkak të vendimeve të caktuara të miratuara nga pushteti qendror, me të cilat u shkurtohen një numër të madh mundësish për përfitime shtesë financiare. U theksua se në pjesën lindore të vendit ndërtimi i centraleve fotovoltaike është në zhvillim e sipër, nga të cilat komunat nuk marrin asnjë denarë. Bordi drejtues konsideron se komunat kanë të drejtë për kompensim nga energjia e prodhuar elektrike nga burimet alternative të energjisë në shumë prej më së pakut 2% nga kundërvlera monetare e energjisë së prodhuar elektrike. Kjo metodologji duhet të zbatohet edhe në rastin e shfrytëzimit të ujërave dhe prerjes së pyjeve, për të cilën gjë do të debatohet në seancën e ardhshme të Bordit drejtues sipas një propozim – iniciative të përgatitur. Për këtë qëllim u propozua që të formohet një komision i përbërë nga anëtarë të Bordit drejtues, i cili duhet të përgatisë një analizë dhe propozim – iniciativë.

Bordi drejtues e përcaktoi edhe përbërjen e komisionit, i cili duhet të përcaktojë se cilat komuna do t'i dhurohen dy automjetet që janë në pronësi të BNJVL-së. Lidhur me këtë u përcaktuan disa kritere sipas të cilave anëtarët e komisionit duhet të vendosin, ndër të cilat t'i përjashtojnë komunat më të mëdha dhe të gjitha komunat nga rajoni i Shkupit; të përqendrohen komunave rurale që kanë maksimum 10.000 banorë; të njëjtat të mos kenë në dispozicion një park të madh automjetesh dhe të kenë paguar anëtarësinë ndaj BNJVL-së. Propozimet do të shqyrtohen në seancën e ardhshme të Bordit drejtues.

Në seancë u miratua Memorandumi për bashkëpunim i Shoqatës së qytetarëve për zhvillim personal, edukim dhe ndihmë dhe mbështetje psikologjike “Zëri nga qetësia” - Shkup, me BNJVL-në. Qëllimi është të ngrihet ndërgjegjësimi social ndaj fëmijëve me aftësi të kufizuara zhvillimore, të krijohet një përfshirje e vërtetë, të edukohen mësuesit dhe personat ekspertë të kësaj sfere dhe të përfshihet dhuna nga bashkëmoshatarët (bullingu), identifikimi i tij dhe trajtimi i tij në situata të tilla. Memorandumi do të dërgohet në të gjitha komunat.





## ЗЕЛС ЌЕ ИМ ОБЕЗБЕДИ ПОДДРШКА НА ИЗБРАНИТЕ ОПШТИНИ ЗА ИНТЕГРИРАЊЕ НА ИНДИКАТОРИ ЗА РОДОВА ЕДНАКВОСТ ВО ПРОГРАМИТЕ

Општините кои се заинтересирани да интегрираат индикатори за родова еднаквост во своите годишни програми имаат можност да добијат директна менторска поддршка од ЗЕЛС. Оваа активност ЗЕЛС ќе ја реализира во согласност со Стратегијата за родова еднаквост на ЗЕЛС и Акцискиот план за 2024 година. По тој повод, ЗЕЛС достави повик до сите општини за вклучување во менторската програма за спроведување на работилници за интегрирање на родови индикатори во една општинска програма што ќе ја избере општината.

Пријавувањето на заинтересираните општини треба да биде најдоцна до 8 март 2024 година, кога врз основа на утврдените критериуми и според принципот „прв пријавен – прв услужен", ќе бидат избрани најмногу четири општини кои ќе добијат соодветна поддршка. Општините што ќе аплицираат, треба да се подготвени да обезбедат соодветен простор и логистичка поддршка за организирање на работилниците во својата општина, а ЗЕЛС ја има обврската да го води менторирањето на целиот процес, во текот на работилниците. Предвидено е да се организираат најмалку две, а најмногу четири работилници во секоја од избраните општини.

Исто така, општината задолжително треба да ја има усвоено Европската повелба за родова еднаквост; да има Програма за еднакви можности на мажите и жените за 2024 година; да има активна Комисија за еднакви можности на мажите и жените; во изминатата година да спровела најмалку три мерки од минатогодишната Програма за еднакви можности и да ја има платено членарините кон ЗЕЛС, заклучно со 2023 година. Општините ќе бидат навремено известени по истекот на предвидениот рок за аплицирање и по направената анализа за избор на општините.

## BNJVL DO TË SIGUROJË MBËSHTETJE PËR KOMUNAT E PËRZGJEDHURA PËR INTEGRIMIN E TREGUESVE TË BARAZISË GJINORE NË PROGRAME

Komunat të cilat janë të interesuara për integrimin e treguesve të barazisë gjinore në programet e tyre vjetore kanë mundësi të marrin mbështetje direkte mentoruese nga BNJVL-ja. BNJVL-ja këtë aktivitet do ta realizojë në përputhje me Strategjinë për barazi gjinore të BNJVL-së dhe Planin aksionar për vitin 2024. Me këtë rast, BNJVL-ja u dërgoi thirrje të gjitha komunave për përfshirje në programin mentorues për realizimin e punëtorive për integrimin e treguesve gjinorë në një program komunal që do ta zgjedh komuna.

Paraqitja e komunave të interesuara duhet të bëhet më së voni deri më 8 mars 2024, kur në bazë të kritereve të përcaktuara dhe sipas parimit "komuna që ka aplikuar e para, do shërbehet e para", do të përzgjidhen më së shumti katër komuna që do të marrin mbështetjen përkatëse. Komunat që do të aplikojnë duhet të jenë të gatshme të sigurojnë hapësirë adekuate dhe mbështetje logjistike për organizimin e punëtorive në komunën e tyre, ndërsa BNJVL-ja ka për obligim të udhëheqë mentorimin e gjithë procesit gjatë punëtorive. Është paraparë të organizohen së paku dy, e më së shumti katër punëtori në secilën nga komunat e përzgjedhura.

Gjithashtu, komuna duhet të ketë miratuar Kartën Evropiane për Barazi Gjinore; të ketë Program për mundësi të barabarta të meshkujve dhe femrave për vitin 2024; të ketë komision aktiv për mundësi të barabarta të meshkujve dhe femrave; në vitin e kaluar të ketë zbatuar së paku tri masa nga Programi i vitit të kaluar për mundësi të barabarta dhe të ketë paguar anëtarësinë ndaj BNJVL-së, përfundimisht me vitin 2023. Komunat do të njoftohen me kohë pas skadimit të afatit të paraparë për aplikim dhe pas analizës së bërë për përzgjedhjen e komunave.

## ЗАПОЧНА НОВ ЦИКЛУС ОБУКИ ЗА СТЕКНУВАЊЕ СО ЛИЦЕНЦА ЗА ВОДЕЊЕ ПОСТАПКИ ЗА ОТУЃУВАЊЕ И ДАВАЊЕ ПОД ЗАКУП НА ДРЖАВНО ГРАДЕЖНО ЗЕМЈИШТЕ

ЗЕЛС, во соработка со Министерството за транспорт и врски (МТВ), на 21 февруари 2024 година, во просториите на ЗЕЛС тренинг центарот, организираше нов циклус на почетна обука за кандидатите од општините за стекнување на овластување за водење постапка за отуѓување и давање под закуп на градежно земјиште во државна сопственост. Интересот за обуките е голем од причина што повеќе општински службеници треба да ја обноват претходно стекнатата лиценца, чие времетраење е пет години. Исто така, во некои од единиците на локалната самоуправа, дел од лиценцираните службеници заминуваат во пензија или на друго работно место, со што се нарушува потребниот број на лица, што, во согласност со законските прописи, треба да го обезбеди општината, а некои општини вработуваат нови службеници во оваа област.

Вкупно 65 кандидати од општините, со статус на административен службеник од редот на раководни или

## FILLOI CIKLI I RI I TRAJNIMEVE PËR MARRJEN E LICENCËS PËR UDHËHEQJEN E PROCEDURAVE PËR TJETËRSIM DHE DHËNIE ME QIRA TË TOKËS NDËRTIMORE SHTETËRORE

BNJVL-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve (MTL), më 21 shkurt 2024, në hapësirat e Qendrës së trajnimeve të BNJVL-së, organizoi një cikël të ri të trajnimeve fillestare për kandidatët nga komunat për marrjen e autorizimit për udhëheqjen e procedurave për tjetërsim dhe dhënie me qira të tokës ndërtimore në pronësi të shtetit. Interesimi për trajnime është i madh për shkak se shumë nëpunës komunalë duhet të ripërtërijnë licencën e fituar paraprakisht, kohëzgjatja e së cilës është pesë vjet. Gjithashtu, në disa nga njësitë e vetëqeverisjes lokale, një pjesë e nëpunësve të licencuar dalin në pension ose shkojnë në një vend tjetër pune, me ç'rast çrregullohet numri i nevojshëm i personave që në përputhje me rregulloret ligjore duhet t'i sigurojë komuna, ndërsa disa komuna punësojnë nëpunës të rinj në këtë sferë.

Gjithsej 65 kandidatë nga komunat, me statusin e një nëpunësi administrativ nga radha e nëpunësve administrativë

стручни административни службеници, се пријавија на огласот што на 31 јануари 2024 година го објави Комисијата за следење на процесот на организирање и спроведување обука и испит. Стручната служба на ЗЕЛС, по извршената проверка за исполнетост на условите на кандидатите, ги информираше пријавените за термините за следење на почетната обука. На почетната обука, присутните, поделени во две групи, имаа можност да се запознаат со законската регулатива од оваа област. Станува збор за една динамична материја проследена и со одредени измени во прописите, но истовремено и комплексна од аспект на имотноправните и другите постапки што треба да се спроведуваат. Лицата што ја проследија почетната обука ќе имаат можност да го полагаат теоретскиот, а потоа и практичниот дел од испитот, за што ќе бидат информирани дополнително. Полагањето се спроведува електронски, во Испитниот центар на Европскиот универзитет, а резултатите се објавуваат на веб-страницата на ЗЕЛС (www.zels.org. mk), веднаш по завршувањето на испитот.

udhëheqës apo profesionalë u paraqitën për shpalljen të cilën e ka publikuar më 31 janar 2024 Komisioni për monitorimin e procesit të organizimit dhe zbatimit të trajnimeve dhe provimeve. Shërbimi profesional i BNJVL-së, pas kontrollit të kryer të plotësimit të kushteve të kandidatëve, i njoftoi kandidatët e paraqitur për datat e ndjekjes së trajnimit fillestar. Në trajnimin fillestar, të pranishmit, të ndarë në dy grupe, patën mundësinë të informohen lidhur me legjislacionin në këtë fushë. Bëhet fjalë për një materi dinamike që ndiqet nga ndryshime të caktuara në rregullore, por në të njëjtën kohë komplekse nga aspekti i procedurave pronësore juridike dhe procedurave të tjera që duhet të zbatohen. Personat që kanë ndjekur trajnimin fillestar do të kenë mundësi të kalojnë së pari pjesën teorike, e pastaj edhe pjesën praktike të provimit, për të cilën gjë do të marrin informacione shtesë. Provimi zbatohet në mënyrë elektronike, në Qendrën e provimeve të Universitetit Evropian, ndërsa rezultatet publikohen në faqen e internetit të BNJVL-së (www.zels.org.mk) menjëherë pas përfundimit të provimit.












ЗАЕДНИЦА НА ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА
НА РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА

BASHKËSIA E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES LOKALE TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT




**КОНТАКТ ИНФОРМАЦИИ**

тел. +389 (0)2 30 99 033 | факс: +389 (0)2 30 61 994
ул. "Копенхагенска" бр. 5, п. фах 32, 1000 Скопје, Република Северна Македонија
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk

**INFORMACIONE PËR KONTAKT:**

tel. +389 (0)2 30 99 033 | faks: +389 (0)2 30 61 994
rr. "Kopenhagenska" nr. 5, F.P. 32, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë së Veriut
contact@zels.org.mk | www.zels.org.mk